



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA FUSHË-ARRËZ
KËSHILLI BASHKIAK

Komisioni i Përhershëm i Zhvillimit Mbrojtjes së Territorit dhe Sherbimve Publike
Transportit dhe Strehimit



Fushe-Arrez, me 25.04.2025

RAPORT VENDIMMARRJE

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë

Lenda: Vendim për shqyrtimin e projekt vendimit nr. 12 datë 22/04/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për percaktimin e cmimit të qirase mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg, për efekt të subvencionimit të qirase në Bashkinë Fushe-Arrez për vitin 2025".

Analiza ligjore: Bazuar në Ligjin 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", Ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social", VKM Nr.362 dt 29.5.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij", VKM Nr.459, dt 3.7.2019 "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin".

Situata aktuale e funksionit: Me objekt: "Përcaktimin e çmimit të qirasë mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg, për efekt të subvencionimit të qirasë në Bashkinë Fushe-Arrez për vitin 2025". Në zbatim të ligjit Nr.22/2018, "Për strehimin social", VKM Nr. 459.dt 03.07.2019, "Për rregullat për administrimin e kërkesave të njësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin", VKM Nr.362 dt 29.05.2019, "Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij pika 4a e këtij vendimi: Njësia e vetëqeverisjes vendore përcakton vlerën konkrete të subvencionimit të qirasë për banesat në pronësi të pronarit social në

tregun e lirë, bazuar në vlerën mesatare të qirave e cila vlerësohet sipas zonave të ndryshme urbane e rurale.

Prandaj lind nevoja e miratimit të një vendimi të Këshillit Bashkiak për përcaktimin e çmimit të qirasë mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve të banimit në treg, për efekt të zbatimit të programit subvencionim i qerasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, masë e cila llogaritet në varësi të çmimit mesatar të qirasë në treg.

Ky nivel çmimesh miratuar në këtë vendim është arritur në përfundimin referuar ofertave të marra në treg për çmimin e qirave të apartamenteve në qytetin Fushë-Arrëz dhe periferi për vitin kalendarik 2024 si dhe kontratave noteriale qiraje të shoqëruara me kërkesën për strehimin social nga programi i subvencionimit të qirasë.

Situata financiare: Referuar ofertave të marra në treg për çmimin e qirave në qytetin Fushë-Arrëz dhe rrethina për vitin kalendarik 2024, për vitin 2025 propozohet miratimi I çmimit mesatar të qirave të banesave për efekt subvencionimi të qirasë sipas strukturës:

	Urbane	Rurale
a) Për apartment të tipit "Garsionere"	7000	5000
b) Për apartment të tipit 1+1	12000	8000
c) Për apartment të tipit 2+1	15000	1000
d) Për apartment të tipit 3+1	23000	13000

Drejtoria / Sektori përgjegjës:

Drejtoria e Ceshtjeve Sociale e ka relatuar përpara komisionit për Projekt vendimin

Monitorimi dhe raportimi: Komisioni i Zhvillimit të territorit dhe strehimit dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.

Impakti social / grupet që preken: projekt vendimi impakton jetën të gjitha shtresave, kategorive në veshtiresi strehimi në Bashkinë Fushe Arrez

A është objekt i konsultimit publik: Nuk është objekt konsultimi

Komisioni i mbledhur me datën 25/04/2025 shqyrtoi projekt vendimit nr. 12 datë 22/04/2025, relacionit e dokumentat shoqërues në lidhje me propozimin për "Për përcaktimin e çmimit të qirase mesatare të njësive të banimit dhe apartamenteve në treg, për efekt të subvencionimit të qirase në Bashkinë Fushe-Arrez për vitin 2025" paraqitur nga Kryetari i Bashkisë.

Pas shqyrtimit të projekt vendimit dhe materialeve shoqëruese,

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI

1. T'i propozojë Këshillit Bashkiak:

- a) kalimin e projektaktit në Mbledhjen e Këshillit për vlerësim të mëtejshëm dhe shqyrtim
- b) miratimin e projektaktit

Bashkëlidhur **argumentat e vendimmarrjes dhe mendimi i pakicës** i paraqitur në
proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit

Afrim Ndoj

(emri, mbiemri, firma)

Kryetar i Komisionit

Mustaf Passhkaj

(emri, mbiemri, firma)

Sekretar i Komisionit